



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 177

dhjetor

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 115/2012 datë 13.12.2012	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për konfliktet e ligjeve në lidhje me formën e disponimeve testamentare” 10593
Ligj nr. 120/2012 datë 20.12.2012	Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e komunitetit “Doganat 2013” 10597
Ligj nr. 121/2012 datë 20.12.2012	Për një ndryshim në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar 10603
Ligj nr. 122/2012 datë 20.12.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar... 10604
Ligj nr. 123/2012 datë 20.12.2012	Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar... 10605
Ligj nr. 124/2012 datë 20.12.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 10606
Ligj nr. 125/2012 datë 20.12.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar 10607
Ligj nr. 126/2012 datë 20.12.2012	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”” 10609

Udhëzim i KM nr. 4, datë 12.12.2012	Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor.....	10610
Vendim i ERE nr. 169, datë 18.12.2012	Për miratimin e skemës së përlllogaritjes së kapacitetit total të transmetimit të energjisë elektrike.....	10611

LIGJ
Nr. 115/2012

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN “PËR
KONFLIKTET E LIGJEVE NË LIDHJE ME FORMËN E DISPONIMEVE
TESTAMENTARE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën “Për konfliktet e ligjeve në lidhje me formën e disponimeve testamentare”, bërë në Hagë më 5 tetor 1961.

Neni 2

Në zbatim të nenit 10 të konventës, Republika e Shqipërisë nuk njeh disponimet e bëra verbalisht nga një shtetas shqiptar, i cili nuk posedon ndonjë shtetësi tjetër, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme.

Në zbatim të nenit 12 të konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën e përjashtimit nga zbatimi i konventës të çdo dispozite testamentare, e cila, sipas legjislacionit shqiptar, nuk ka lidhje me çështje të së drejtës së trashëgimisë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7873, datë 26.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

KONVENTA
PËR KONFLIKTET E LIGJEVE NË LIDHJE ME FORMËN E DISPONIMEVE
TESTAMENTARE
(LIDHUR MË 5 TETOR 1961)

Shtetet nënshkruese të kësaj konvente,
Me dëshirën për të vendosur dispozita të përbashkëta për konfliktet e ligjit në lidhje me format e disponimeve testamentare,
kanë vendosur të lidhin një konventë për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:



Neni 1

Një disponim testamentar është i vlefshëm në lidhje me formën, nëse forma e tij është në përputhje me ligjin e brendshëm:

- a) të vendit ku trashëgimlënësi e ka bërë atë; ose
- b) të vendit, të shtetësisë e të cilit ka pasur trashëgimlënësi në kohën kur ka bërë disponimin testamentar, ose në kohën e vdekjes së tij; ose
- c) të vendit, në të cilin trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin e tij ose në kohën kur ka bërë disponimin, ose në kohën e vdekjes së tij; ose
- d) të vendit, në të cilin trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin e tij të zakonshëm si në kohën kur ka bërë disponimin, ose në kohën e vdekjes së tij; ose
- e) të vendit, ku ndodhet pasuria e paluajtshme e disponuar me testament.

Për qëllimet e kësaj konvente, nëse një ligj kombëtar përbëhet nga një sistem i paunifikuar, ligji që duhet të zbatohet përcaktohet nga rregullat në fuqi në atë sistem dhe në pamundësi të këtyre rregullave, nga lidhja më e afërt që trashëgimlënësi ka pasur me ndonjë prej ligjeve të ndryshme brenda atij sistemi.

Përcaktimi nëse trashëgimlënësi ka pasur ose jo vendbanimin e tij në një vend të caktuar, rregullohet nga ligji i këtij vendi.

Neni 2

Neni 1 do të zbatohet për disponimet testamentare që revokojnë një disponim të mëparshëm testamentar.

Revokimi do të jetë i vlefshëm për sa i përket formës, nëse është në përputhje me ndonjë prej ligjeve të përcaktuara në nenin 1, referuar të cilave, disponimi testamentar që është revokuar do të ishte i vlefshëm.

Neni 3

Kjo konventë nuk do të cenojë normat ligjore ekzistuese ose të ardhshme të shteteve kontraktuese, që njohim disponimet testamentare të bëra në përputhje me kërkesat formale të një ligji të ndryshëm nga një ligj i përmendur në nenet e sipërcituara.

Neni 4

Kjo konventë zbatohet edhe për formën e disponimeve testamentare të bëra nga dy ose më shumë persona në një dokument.

Neni 5

Për qëllimet e kësaj konvente, çdo dispozitë ligjore që kufizon format e lejuara të disponimeve testamentare, të cilat lidhen me moshën, shtetësinë ose rrethanave të tjera personale të trashëgimlënësit, do të vlerësohen si të lidhura me çështjet e formës. I njëjti rregull zbatohet për cilësitë që duhet të zotërohen nga dëshmitarët, të kërkuara për vlefshmërinë e një disponimi testamentar.

Neni 6

Zbatimi i rregullave të konflikteve të përcaktuara në këtë konventë nuk është i varur nga ndonjë kërkesë reciprociteti.

Konventa zbatohet edhe nëse shtetësia e personave të përfshirë apo ligj që duhet të zbatohet në bazë të neneve të mësipërme, nuk është ai i një shteti kontraktues.

Neni 7

Zbatimi i ndonjë prej ligjeve të deklaruara të zbatueshme nga kjo konventë mund të refuzohet vetëm nëse është haptazi në kundërshtim me “*ordre public*”.

Neni 8

Kjo konventë zbatohet në të gjitha rastet kur trashëgimlënësi vdes pas hyrjes së saj në fuqi.

Neni 9

Çdo shtet kontraktues mund të rezervojë të drejtën, në derogim të paragrafit të tretë të nenit 1, të përcaktojë në përputhje me *lex fori* vendin ku trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin e tij.

Neni 10

Çdo shtet kontraktues mund të rezervojë të drejtën për të mos njohur disponimet testamentare të bëra verbalisht, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, kur këto disponime janë bërë nga një prej shtetasve të tij, i cili që nuk ka shtetësi tjetër.

Neni 11

Çdo shtet kontraktues, referuar dispozitave të legjislacionit të brendshëm, mund të rezervojë të drejtën për të mos njohur, format e disponimeve testamentare të bëra jashtë shtetit kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) disponimi testamentar është i vlefshëm në formë vetëm për shkak vetëm të zbatimit të ligjit të vendit ku trashëgimlënësi ka bërë disponimin e tij;
- b) trashëgimlënësi ka pasur shtetësinë e shtetit që bën rezervën;
- c) trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin në shtetin e lartpërmendur ose ka pasur aty vendbanimin e tij të zakonshëm; dhe
- d) trashëgimlënësi ka vdekur në një shtet të ndryshëm nga ai në të cilin kishte bërë disponimin e tij.

Kjo rezervë ka fuqi ligjore vetëm në lidhje me pasurinë e ndodhur në shtetin që bën rezervën.

Neni 12

Çdo shtet kontraktues mund të rezervojë të drejtën për të përjashtuar nga zbatimi i kësaj konvente çdo klauzolë testamentare, e cila sipas ligjit të tij, nuk ka lidhje me çështje të së drejtës së trashëgimisë.

Neni 13

Çdo shtet kontraktues mund të rezervojë të drejtën, në derogim të nenit 8, të zbatojë këtë konventë vetëm për testamentare të bëra pas hyrjes së saj në fuqi.



Neni 14

Kjo konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet e përfaqësuara në sesionin e nëntë të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Ajo ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Neni 15

Kjo konventë hyn në fuqi ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit të përmendur në paragrafin e dytë të nenit 14.

Konventa hyn në fuqi për çdo shtet nënshkrues që e ratifikon atë në një kohë të mëpasshme, ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit.

Neni 16

Çdo shtet që nuk është përfaqësuar në sesionin e nëntë të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private mund të aderojë në këtë konventë pasi të ketë hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 15. Instrumenti i aderimit depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Konventa hyn në fuqi për një shtet që ka aderuar në të ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të saj të aderimit.

Neni 17

Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, mund të deklarojë se kjo konventë do të shtrihet në të gjitha territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është përgjegjës ose në një, ose më shumë prej tyre. Kjo deklaratë hyn në fuqi datën e hyrjes në fuqi të konventës për shtetin përkatës.

Në çdo kohë më pas, Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës njoftohet në lidhje me këto shtrirje.

Konventa hyn në fuqi për territoret e përmendura në këtë shtrirje, ditën e gjashtëdhjetë pas njoftimit të përmendur në paragrafin pararendës.

Neni 18

Çdo shtet, jo më vonë se momenti i ratifikimit ose aderimit të tij, mund të bëjë një ose më shumë nga rezervat e përmendura në nenet 9, 10, 11, 12 dhe 13 të kësaj konvente. Nuk lejohet asnjë rezervë tjetër.

Në njoftimin e një shtrirjeje të konventës, në përputhje me nenin 17, çdo shtet kontraktues mund të bëjë një ose më shumë nga rezervat e lartpërmendura, me efektin e saj të kufizuar në të gjitha ose disa prej territoreve të përmendura në shtrirje.

Çdo shtet kontraktues mund të tërheqë në çdo kohë një rezervë që ka bërë. Kjo tërheqje i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Kjo rezervë pushon së qeni në fuqi ditën e gjashtëdhjetë pas njoftimit të përmendur në paragrafin pararendës.

Neni 19

Kjo konventë mbetet në fuqi për pesë vjet nga data e hyrjes së saj në fuqi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 15, edhe për shtetet që e kanë ratifikuar ose kanë aderuar më pas në të.

Nëse nuk ka pasur një denoncim të tillë, ajo rishikohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet.
Çdo denoncim i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës të paktën gjashtë muaj para përfundimit të periudhës pesëvjeçare.

Ai mund të kufizohet në disa prej territoreve në të cilat zbatohet konventa.

Denoncimi ka fuqi vetëm në lidhje me shtetin që e ka njoftuar atë. Konventa mbetet në fuqi për shtetet e tjera kontraktuese.

Neni 20

Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës i jep njoftim shteteve të përmendura në nenin 14 dhe shteteve që kanë aderuar në përputhje me nenin 16, për sa më poshtë:

- a) nënshkrimet dhe ratifikimet e përmendura në nenin 14;
- b) datën në të cilën kjo konventë hyn në fuqi, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 15;
- c) aderimet e përmendura në nenin 16 dhe datën në të cilën ato hyjnë në fuqi;
- d) shtrirjet e përmendura në nenin 17 dhe datën në të cilën ato hyjnë në fuqi;
- e) rezervat dhe tërheqjet e përmendura në nenin 18;
- f) denoncimet e përmendura në paragrafin e tretë të nenit 19.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë konventë.

Bërë në Hagë më 5 tetor 1961, në gjuhën angleze dhe frënge, ku teksti në gjuhën frënge ka përparësi midis dy teksteve, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e qeverisë së Holandës, dhe nga të cilat një kopje e vërtetuar i dërgohet me rrugë diplomatike secilit prej shteteve të përfaqësuar në sesionin e nëntë të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

LIGJ

Nr. 120/2012

PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EUROPIAN PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E KOMUNITETIT “DOGANAT 2013”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e komunitetit “Doganat 2013”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7909, datë 7.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EUROPIAN MBI
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E KOMUNITETIT
“DOGANAT 2013”

Komisioni Europian, që më poshtë referohet si “Komisioni”, në emër të Bashkimit Europian, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, që më poshtë referohet si “Shqipëria”, nga ana tjetër,

meqë:

1. Marrëveshja kuadër mes Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit, nënshkruar më 22 nëntor 2004, e cila ka hyrë në fuqi më 11 korrik 2005¹, përcakton parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë (në vijim do të referohet si “Shqipëria”) në programet e Komunitetit, duke ia lënë Komisionit Europian (në vijim do të referohet si “Komisioni”) dhe autoriteteve kompetente të Shqipërisë për të specifikuar termat dhe kushtet specifike, përfshi edhe kontributin financiar lidhur me këtë pjesëmarrje në çdo program të veçantë;

2. Në përputhje me nenin 1 (2) të marrëveshjes kuadër, Shqipëria lejohet të marrë pjesë në programet e përcaktuara apo të rinovuara të Komunitetit pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe që përmbajnë një dispozitë të hapur që parashikon pjesëmarrjen e Shqipërisë;

3. Në përputhje në nenin 5 të marrëveshjes kuadër, termat dhe kushtet specifike lidhur me pjesëmarrjen e Shqipërisë në çdo program të veçantë do të përcaktohen nga një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Komisionit Europian, që vepron në emër të Komunitetit dhe Shqipërisë;

4. Programi “Doganat 2013” u përcaktua me vendimin nr. 624/2007/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit në 23 maj 2007;²

5. Në përputhje me nenin 3 (2) pika “b” të këtij vendimi nr. 624/2007/EC, programi “Doganat 2013” është i hapur për pjesëmarrjen e vendeve kandidatë potenciale, në përputhje me dispozitat që duhen përcaktuar me këto vende, në vijim të realizimit të marrëveshjeve kuadër lidhur me pjesëmarrjen e tyre në programet e Komunitetit.

6. Shqipëria ka shprehur dëshirën që të marrë pjesë në programin “Doganat 2013” dhe ka negociuar një memorandum mirëkuptimi me Komisionin, duke përcaktuar terma dhe kushte specifike, përfshi edhe kontributin financiar, lidhur me pjesëmarrjen e saj në program,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shqipëria do të marrë pjesë në “Programin Dogana 2013” (që më tej do t’i referohemi si “programi”) në përputhje me kushtet e paraqitura në marrëveshjen kuadër ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Komunitetit dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në nenet 2-4 të këtij memorandum mirëkuptimi.

Neni 2

Termet dhe kushtet lidhur me pjesëmarrjen në program

1. Shqipëria do të marrë pjesë në aktivitetet e programit në përputhje me objektivat dhe procedurat që përcakton vendimi nr. 624/2007/EC i Parlamentit Europian dhe vendimi i Këshillit të 23 majit 2007, si edhe sipas kushteve dhe grafikut më poshtë:

¹ 1011 192.2207.2005.p.2

² 2011.154.14.6.2007.p.25

- duke filluar nga 1 prilli 2012, pjesëmarrje në aktivitetet e përcaktuara në nenet 8, 9, 10, 11,12,13 dhe 15 të vendimit me nr. 624/2007/EC, me përjashtim të rasteve kur natyra dhe përmbajtja e aktivitetit nuk lejon pjesëmarrjen e Shqipërisë;

- nga momenti që palët bien dakord mes tyre në nivel operativ para anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin European ose para anëtarësimit të saj në Konventën e Transittit të Përbashkët, pjesëmarrje në aktivitetet e përcaktuara në nenin 7 2(a) të vendimit me nr. 624/2007/EC, në përputhje me aneksin I, pika 1, nënparagrafi i dytë dhe i tretë i këtij memorandumi.

2. Termat dhe kushte që do të zbatohen për pranimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve për zyrtarë të Shqipërisë, do të jenë të njëjta me ata që do të zbatohen për zyrtarët e administratave të shteteve anëtare të Bashkimit European.

3. Për të marrë pjesë në program, Shqipëria do të paguajë çdo vit një kontribut financiar në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit European në përputhje me nenin 3 më poshtë. Kontributi financiar i Shqipërisë lidhur me pjesëmarrjen në program dhe zbatimin e tij, do t'i shtohet sasisë së përcaktuar çdo vit në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit European për ndarjen e angazhimeve, me qëllim realizimin e detyrimeve financiare që rrjedhin nga format e ndryshme të masave të nevojshme për të ekzekutuar, menaxhuar dhe zbatuar programin.

4. Para fillimit të çdo viti buxhetor përfundohet një marrëveshje grant ndërmjet Komisionit dhe vendeve pjesëmarrëse në program. Granti mbulon kostot e pjesëmarrjes dhe kostot organizative për aktivitetet e përcaktuara në nenin 2 (1).

Pas anëtarësimit të Shqipërisë në marrëveshjen grant me Komisionin, pjesa përkatëse e grantit bëhet e disponueshme për autoritetet kombëtare nëpërmjet pagesave që bëhen nga Komisioni. Transferi për Shqipërinë e pjesës së grantit që mbulon kostot e pjesëmarrjes për aktivitete të përbashkëta kushtëzohet me pagesën paraprake të kontributit financiar që Shqipëria i bën Komisionit për atë vit buxhetor.

5. Një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit European do të përdoret për procedurat që lidhen me zbatimin e kontratave dhe marrëveshjeve grant, për raportet dhe kërkesat për pagesa, si dhe për aspekte të tjera administrative të programit.

Neni 3

Kontributi financiar

1. Rregullat që përcaktojnë kontributin financiar të Shqipërisë jepen në aneksin I.

2. Një pjesë e kontributit financiar mund të financohet nën instrumentin përkatës të ndihmës së huaj të Bashkimit European, nëse Shqipëria e kërkon këtë. Në këtë rast, financimi nga fondet e paraanëtarësimit të Bashkimit European, do të specifikohet në Memorandumin e Financimit në programin vjetor lidhur me këtë asistencë.

Neni 4

Raportimi dhe vlerësimi

1. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe Gjykatës Europiane të Auditimit në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në program do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme mbi bazë partneriteti që përfshin Komisionin dhe Shqipërinë. Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit raportet përkatëse dhe do të marrë pjesë në aktivitete të tjera specifike të përcaktuara nga Bashkimi European në këtë kontekst.

2. Në përputhje me rregulloren e Këshillit (EC, Euratom) nr. 1605/2002 të 25 qershorit 2002, mbi rregulloren financiare që aplikohet për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve



Europiane³ dhe rregulloren e Këshillit (EC, Euratom) nr. 2342/2002 të 23 dhjetorit 2002, që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e rregullores së Këshillit (EC, Euratom) nr. 1605/2002 mbi rregulloren financiare që zbatohet për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane⁴ dhe me rregullat e tjera të përcaktuara në këtë memorandum mirëkuptimi, kontratat dhe marrëveshjet grant të përfunduara me përfituesit e programeve të krijuara në Shqipëri, do të sigurojnë auditim financiar apo auditime të tjera, mbi bazë të dokumenteve dhe në terren, që auditimet të mund të kryhen në çdo kohë nga agjentët e Komisionit ose persona të tjerë të mandatuar nga Komisioni.

3. Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të deleguar nga Komisioni, do të kenë aksesin e duhur për dokumentet dhe për të gjithë informacionin që nevojitet për të kryer auditime të tilla, përfshi dhe atë në formë elektronike, për të kryer auditime të tilla. Kjo e drejtë për akses do të përcaktohet në mënyrë të qartë në kontratat dhe marrëveshjet grant që do të realizohen për të zbatuar instrumentet që përcaktohen në këtë memorandum.

4. Gjykata Europiane e Auditimit do të ketë të drejta të njëjta si Komisioni.

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

1. Ky memorandum mirëkuptimi do të zbatohet për sa kohë zgjat programi. Megjithatë, nëse Bashkimi European vendos të zgjatë afatin ose të ndërmarrë një program të ri në vazhdim pa ndonjë ndryshim thelbësor brenda programit, edhe ky memorandum do të zgjatet në kohë, njëkohësisht dhe menjëherë, nëse asnjë nga palët nuk e denoncon brenda një muaji pas zgjatjes së afatit apo marrjes së vendimit përkatës.

2. Projektet dhe aktivitetet në vijim në kohën e përfundimit do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë memorandum mirëkuptimi, sipas marrëveshjeve kontraktuale që zbatojnë këto projekte, si edhe aktivitetet e dispozitave në aneksin II.

3. Aneksat përbëjnë një pjesë integrale të këtij memorandum mirëkuptimi.

4. Ky memorandum mirëkuptimi mund të amendohet vetëm me shkrim me marrëveshje të përbashkët nga palët.

5. Ky memorandum mirëkuptimi do të hyjë në fuqi datën që Komisioni merr njoftimin me shkrim nga Shqipëria nëpërmjet kanaleve diplomatike, se janë përmbushur kërkesat e saj të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të këtij memorandum mirëkuptimi. Ky do të zbatohet prej 1 prillit 2012.

Bërë..... më.....

Bërë në..... më.....

Për Republikën e Shqipërisë
Drejtor i Përgjithshëm i Doganave të Shqipërisë

Për Komisionin,
Në emër të Bashkimit European
.....Walter Deffaa
Drejtor i Përgjithshëm i Komisionit European për
Bashkimin Doganor dhe Tatimet

³ 011 248.16.9.2002, p.1.

⁴ 011 357 31.12.2002, p.1.

ANEKSI I

RREGULLAT QË PËRCAKTOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN “DOGANAT 2013”

1. Kontributi financiar që do të paguhet nga Shqipëria për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian lidhur me pjesëmarrjen në program, do të jetë si më poshtë:

- 50 000 euro për çdo vit pjesëmarrjeje, për të mbuluar aktivitetet që i përkasin nenit 2 (1), nënpika e parë e këtij memorandum;

- një shumë shtesë prej 180 000 euro që paguhet vetëm një herë për vitin që do të bien dakord të dyja palët për të mbuluar kostot për trajnimin dhe instalimin për aktivitetet e referuara në nenin 2 (1), nënpika e dytë e këtij memorandum;

- një shumë vjetore shtesë prej 110 000 euro duke filluar nga viti i përmendur në pikën më sipër për të mbuluar kostot operative për aktivitetet që i referohen nenit 2 (1), nënpika e dytë e këtij memorandum.

2. Kontributi i Shqipërisë do të mbulojë kostot që lidhen me:

- pjesëmarrjen e zyrtarëve të administratës doganore të Shqipërisë në veprimet e përbashkëta të programit, siç përcaktohen në nenin 2 (1) të këtij memorandum;

- lidhjen e administratës doganore të Shqipërisë me rrjetin e përbashkët të komunikimit/ndërfaqen e sistemeve të përbashkëta (CCN/CSI).

3. Kostot e udhëtimit dhe kostot e jetesës për përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për pjesëmarrjen si vëzhgues në punën e Komitetit referuar në nenin 20 të vendimit nr. 624/2007/EC të Këshillit dhe të Parlamentit Europian të 23 majit 2007 ose takime të tjera që lidhen me zbatimin e programit, do të rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë dhe në përputhje me procedurat aktualisht në fuqi për përfaqësuesit e shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

4. Rregullorja financiare që aplikohet për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian do të aplikohet edhe për menaxhimin e kontributit financiar të Shqipërisë.

5. Kur të hyjë në fuqi ky memorandum mirëkuptimi dhe në fillim të çdo viti buxhetor në vijim, Komisioni do t'i dërgojë Shqipërisë kërkesën për fonde, që korrespondon me kontributin e kostove mbuluar nga ky memorandum mirëkuptimi.

6. Ky kontribut do të paguhet në euro në një llogari bankare në euro të Komisionit.

7. Shqipëria do të paguajë kontributin e vet për kostot vjetore në përputhje me kërkesën për fonde jo më vonë se tre muaj pas datës së kërkesës. Çdo vonesë në pagesën e kontributit do të çojë në rritjen e interesit për Shqipërinë mbi sasinë e pagesës që detyrohet, duke filluar nga data e detyrimit. Shkalla e interesit do të jetë ajo që aplikon Banka Qendrore Europiane për operacionet e saj kryesore, siç publikohen në seritë C të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Europian, që është në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie data për shlyerjen e detyrimit, e rritur me 3.5 për qind pikë. Në rast se vonesa e pagesës së kontributit është e tillë që, mund të rrezikojë zbatimin e menaxhimit të programit dhe në rast mospagimi 20 ditë pune pas letrës zyrtare për kujtesë dërguar Shqipërisë nga Komisioni, pjesëmarrja e Shqipërisë në program për vitin në fjalë do të pezullohet.

ANEKS II

KONTROLLI FINANCIAR, REKUPERIMI DHE MASA TË TJERA ANTIMASHTRIM

I. Kontrolli dhe masa të tjera antimashtrim nga Bashkimi Europian

1. Në përputhje me rregulloren financiare që aplikohet për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian dhe me rregulla të tjera që referohen në këtë memorandum mirëkuptimi, kontratat dhe marrëveshjet grant të përfunduara me përfituesit e programeve që janë instaluar në Shqipëri, do të lejojnë auditues financiarë dhe auditues të tjerë që të kryhen në çdo kohë në



ambientet e përfituesve, të kontraktuesve dhe të nënkontraktuesve të tyre nga agjentë të Komisionit dhe persona të tjerë të deleguar nga Komisioni.

2. Agjentët e Komisionit dhe persona të tjerë të deleguar nga Komisioni do të kenë aksesin e duhur për të hyrë në ambientet, punimet dhe dokumentet dhe në të gjithë informacionin, përfshi dhe atë në formë elektronike, që kërkohet në kuadër të kryerjes së auditimeve të tilla. Kjo e drejtë e aksesit do të përcaktohet në mënyrë të qartë në kontratat dhe marrëveshjet grant të përfunduara për të zbatuar instrumentet e referuara në këtë memorandum. Gjykata e Auditimit do të ketë të njëjtat të drejta si dhe Komisioni.

3. Brenda kuadrit të këtij memorandum, Komisioni/ZEAM-Zyra Europiane Antimashtrim (OLAF në origjinal) do të jetë e autorizuar të kryejë inspektime dhe kontrolle në terren në territorin shqiptar, në përputhje me dispozitat procedurale të rregullores së Këshillit (Euratom, EC) nr.2185/96 të 11 nëntorit 1996 lidhur me inspektimet dhe kontrollet në vend/terren, që kryhen nga Komisioni për të mbrojtur interesat financiarë të Bashkimit Europian kundër mashtrimit dhe parregullsive të tjera.⁵

Këto kontrolle dhe inspektime do të përgatiten dhe kryhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritete kompetente shqiptare që caktohen nga autoritetet shqiptare, të cilat do të njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të këtyre kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që të mundësohet ndihma e nevojshme.

Nëse e dëshirojnë autoritetet shqiptare, kontrollet dhe inspektimet në terren mund të kryhen në mënyrë të përbashkët me to.

Atje ku pjesëmarrësit në programe bëjnë rezistencë kundrejt një kontrolli apo inspektimi në terren, autoritetet shqiptare, duke vepruar në përputhje me rregullat kombëtare, do t'i japin Komisionit/inspektorëve të ZEUM(OLAF) atë asistencë që kërkohet për t'i lejuar ata të kryejnë detyrën e tyre për realizimin e kontrollit apo inspektimit në terren.

Komisioni/ZEUM (OLAF) do të raportojë sa më shpejt tek autoritetet shqiptare çdo fakt apo dyshim lidhur me parregullsitë që ka konstatuar në rrjedhën e kontrollit apo inspektimit në terren. Në çdo rast, Komisioni/ZEUM (OLAF) do t'i kërkohet të informojë autoritete e lartpërmendura për rezultatin e kontrolleve dhe inspektimeve të tilla.

II. Informacioni dhe konsultimi

1. Me qëllim zbatimin e duhur të këtij aneksi, autoritetet kompetente shqiptare dhe ato të Bashkimit Europian do të shkëmbejnë informacion në mënyrë të rregullt dhe me kërkesë të njëjës prej palëve, do të kryejnë konsultime.

2. Autoritetet kompetente shqiptare do të informojnë pa vonesë Komisionin për çdo fakt apo dyshim që kanë hasur apo konstatuar, lidhur me parregullsi në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kontratave dhe marrëveshjeve grant, të realizuara në zbatim të instrumenteve referuar në këtë memorandum.

III. Ndëshkimet dhe masat administrative

Pa cenuar zbatimin e Kodit Penal Shqiptar, ndëshkimet dhe masat administrative mund të imponohen nga Komisioni në përputhje me rregulloren financiare që aplikohet për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian.

IV. Rekuperimi

1. Në Shqipëri do të zbatohen vendimet që merren nga komisioni brenda kuadrit të këtij memorandum, që sanksionojnë një obligim financiar mbi persona fizikë ose juridikë, me përjashtim të rastit kur person juridik janë shtete. Zbatimi do të jetë në përputhje me rregullat e procedurës civile në fuqi në shtetin në territorin e të cilit kryhet. Urdhri për zbatimin e një vendimi do t'i bashkëngjitet vendimit pa ndonjë formalitet tjetër, veç verifikimit të autenticitetit të vendimit nga autoriteti kombëtar që do të caktojë qeveria shqiptare dhe që do t'ia njoftojë Komisionit. Kur të

⁵ 011 202.15.11.1996

plotësohen këto formalitete nga Komisioni, ky i fundit mund të procedojë me zbatimin e vendimit në përputhje me ligjin vendas, duke e sjellë çështjen direkt para autoritetit kompetent. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit do t'i nënshtrohet kontrollit nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European.

2. Gjykimet që bëhen nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European në përputhje me këtë dispozitë arbitrazhi në një kontratë apo në një marrëveshje grant brenda kuadrit të këtij memorandumi, do të jenë të detyrueshme për t'u zbatuar në të njëjtat kushte.

LIGJ

Nr. 121/2012

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 61/2012 “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Seksioni I “Kafe” i shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohet me seksionin me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.12.2012

Shpallur me dekretin nr.7910, datë 7.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

I. “KAFFE”

Kategoria	Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla e taksimit
C200 Kafe e pjekur	09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	60 lekë/kg
C300 Lëkura, lëvoret, zëvendësuesit e kafesë	09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë. Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	50 lekë/kg
C900 Ekstrakte, esenca, koncentre kafeje, përgatitje prej tyre	21 01 11 00 21 01 12 98	Ekstrakte, esenca, koncentre kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.)	250 lekë/kg



LIGJ
Nr. 122/2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998 “PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8/1 “Të ardhura të përjashtuara”, pas pikës 8 shtohen pikat 9 e 10 me këtë përmbajtje:

“9. Përfitimet për dëmshtëpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore.

10. Të ardhurat e përfituara nga institucionet shtetërore për arritjet në shkencë, sport, kulturë.”.

Neni 2

Në nenin 13/2 pika 1, pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje:

“gj) Për të vetëpunësuarit, të cilët kanë një qarkullim nën 2 (dy) milionë lekë, si e ardhur bruto konsiderohet vlera 10 për qind e të ardhurave vjetore bruto nga zhvillimi i aktivitetit ekonomik/tregtar apo shërbime.”.

Neni 3

Në fund të nenit 20 “Shpenzime të njohura” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Bursat që u jepen nxënësve dhe studentëve nga institucionet arsimore, publike dhe jopublike, njihen si shpenzim i zbritshëm deri në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, me kusht që institucionet arsimore publike dhe jopublike, në fillim të vitit shkollor, të paraqesin pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës numrin dhe shumën e bursave.”.

Neni 4

Në nenin 27 “Mbartja e humbjeve”, në pikën 2 fjalët “ndryshon me më shumë se 25 për qind” zëvendësohen me fjalët “ndryshon me më shumë se 50 për qind”.

Neni 5

Në nenin 38 “Dispozitat kalimtare”, në pikën 7, në fund të paragrafit të tretë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ndaj individëve, të parashikuar në këtë ligj, të cilët kanë bërë ose bëjnë deklarinimin e të ardhurave personale për vitin fiskal 2011, pas datës 30 shtator 2012, nuk aplikohen gjobat për mosdeklarim në afat, për deklarimet e bëra deri në datën 31 dhjetor 2012.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7911, datë 7.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 123/2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9981, DATË 8.9.2008 “PËR MIRATIMIN E
NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet ligjit nr. 9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, për kodet tarifore të NK 0901 11 00 “Kafe e papjekur e padekafeinizuar” dhe 0901 12 00 “Kafe e papjekur e dekafeinizuar”, tarifa doganore nga 10 për qind bëhet 0 për qind.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7912, datë 7.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



LIGJ
Nr. 124/2012

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008 “PËR
PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 9 pika 1, fjalët “pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit” zëvendësohen me fjalët “pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore”.

Neni 2

Në nenin 45 pika 1, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:
“c) Përfaqësuesi tatimor, me përmbushjen e detyrimeve tatimore si i tillë.”.

Neni 3

Në nenin 45 pika 3, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:
“Qendra Kombëtare e Regjistrimit ose gjykata njofton organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit ose për kërkesën për çregjistrim të personit fizik, apo për aplikimin për çregjistrim të personit juridik edhe kur kemi të bëjmë me aplikimin për çregjistrim pa kryerjen e likuidimit.”.

Neni 4

Në nenin 114 “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Përrjashtimisht, dispozitat e këtij neni nuk aplikohen për rastet e institucioneve buxhetore, të cilat vonesat në pagimin e detyrimeve tatimore dhe kontributeve i kanë bërë për shkak të vonesave në çeljen e fondeve buxhetore.”.

Neni 5

Në nenin 119 “Mosdeklarimi i punonjësve”, në pikën 1, shkronjat “a” dhe “b” ndryshohen si më poshtë:

“a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh;

b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7913, datë 7.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 125/2012**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 7928, DATË 27.4.1995 “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 19 “Furnizimet e përjashtuara”, në pikën 1, pas numrit “25.9” shtohet numri “25.10”.

Neni 2

Pas nenit 25/9 shtohet neni 25/10 me këtë përmbajtje:

**“Neni 25/10
Hekuri dhe çimentoja**

Furnizimi i hekurit, i klasifikuar në krerët 7213 dhe 7214 të NKM-së dhe çimentos, i klasifikuar në kodet 2523 29 00; 2523 30 00 dhe 2523 90 00 të NKM-së ndaj subjekteve ndërtuese të hidrocentraleve, të cilat, në bazë të marrëveshjes respektive, i përdorin si lëndë të parë për ndërtimin e hidrocentraleve, është furnizim i përjashtuar. Procedura e përjashtimeve, kriteret dhe përcaktimi i llojit e sasisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Në nenin 26 “Importimi i mallrave”, fjalia e parë e pikës 2.1 zëvendësohet me fjalinë me këtë përmbajtje:



“Për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, në kuptim të këtij ligji, në funksion të veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht nga lloji i saj, me përjashtim të makinerive dhe pajisjeve të përcaktuara në shkronjat “g” dhe “gj” të nenit 26/1 të këtij ligji, zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së deri në 12 muaj.”.

Neni 4

Në nenin 26/1 “Furnizimet e përjashtuara në import”, pas shkronjës “f” shtohen shkronjat “g”, “gj”, “h” dhe “i” me këtë përmbajtje:

“g) Importimi i makinerive dhe pajisjeve, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë në dhe mbi 50 milionë lekë, është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Lista e makinerive dhe pajisjeve që janë direkt të lidhura me investimin, procedura e përjashtimeve dhe kriteret përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Për këto makineri dhe pajisje, të cilat janë importuar nën skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së dhe afati i dhënies së autorizimeve nga administrata doganore ose nga Ministri i Financave nuk ka mbaruar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, tatimi mbi vlerën e shtuar përjashtohet. Në rastet kur TVSH-ja e shtyrë është paguar, shumata e paguar nuk rimbursohet.

Në rastin e subjekteve, të cilat kanë bërë importim të makinerive dhe pajisjeve, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë në dhe mbi 50 milionë lekë, nën skemën e shtyrjes së TVSH-së dhe për të cilat ka mbaruar afati i shtyrjes së autorizimit nga administrata doganore apo Ministri i Financave në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe nuk kanë TVSH për rimbursim tek administrata tatimore, u shuhet borxhi doganor.

Në rastin e subjekteve, të cilat kanë bërë importim të makinerive dhe pajisjeve, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë në dhe mbi 50 milionë lekë, nën skemën e shtyrjes së TVSH-së dhe për të cilat ka mbaruar afati i shtyrjes së autorizimit nga administrata doganore apo Ministri i Financave në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe kanë TVSH për t’u rimbursuar nga administrata tatimore, u shuhet borxhi doganor për TVSH-në e shtyrë, me kusht që të mos pretendojnë shumën e TVSH-së për rimbursim tek administrata tatimore. Procedurat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

gj) Importimi i makinerive dhe pajisjeve, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve, pavarësisht nga vlera e investimit, është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Kategoritë e operatorëve ekonomikë, që përfshihen në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Lista e makinerive dhe pajisjeve, që janë direkt të lidhura me investimin, procedura e përjashtimeve dhe kriteret përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Për këto makineri dhe pajisje, të cilat janë importuar nën skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së dhe afati i dhënies së autorizimeve nga administrata doganore ose nga Ministri i Financave nuk ka mbaruar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, tatimi mbi vlerën e shtuar përjashtohet.

Në rastet kur TVSH-ja e shtyrë është paguar, shumata e paguar nuk rimbursohet.

Në rastin e subjekteve, të cilat kanë bërë importim të makinerive dhe pajisjeve, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit, nën skemën e shtyrjes së TVSH-së dhe për të cilat ka mbaruar afati i shtyrjes së autorizimit nga administrata doganore apo Ministri i Financave në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe nuk kanë TVSH për t’u rimbursuar nga administrata tatimore, borxhi doganor shuhet.

Në rastin e subjekteve, të cilat kanë bërë importim të makinerive dhe pajisjeve, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit, nën skemën e shtyrjes së TVSH-së dhe për të cilat ka mbaruar afati i shtyrjes së autorizimit nga

administrata doganore apo Ministri i Financave në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe kanë TVSH për t'u rimbursuar nga administrata tatimore, u shuhet borxhi doganor për TVSH-në e shtyrë, me kusht që të mos pretendojnë shumën e TVSH-së për rimbursim tek administrata tatimore. Procedurat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

h) Importimi i hekurit, i klasifikuar në kërret 7213 dhe 7214 të NKM-së dhe çimentos, e klasifikuar në kodet 2523 29 00, 2523 30 00 dhe 2523 90 00 të NKM-së, të importuar nga subjektet ndërtuese të hidrocentraleve, të cilat, në bazë të marrëveshjeve respektive, i përdorin si lëndë të parë për ndërtimin e hidrocentraleve, është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Procedura e përjashtimeve, kriteret dhe përcaktimi i llojit e sasisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

i) Importimi i makinerive prodhuese nga subjektet e tatimit mbi të ardhurat personale mbi biznesin e vogël, në funksion të realizimit të aktivitetit të tyre prodhues, është furnizim i përjashtuar. Lista e makinerive prodhuese që janë direkt të lidhura me investimin, procedura e përjashtimeve dhe kriteret përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 20.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7914, datë 7.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 126/2012**

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 6, DATË
12.12.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.
10 487, DATË 5.12.2011 “PËR BUXHETIN E VITIT 2012””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 12.12.2012, i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012””.

Miratur në datën 20.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7915, datë 7.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



UDHËZIM
Nr. 4, datë 12.12.2012

PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPENZIMEVE DHE PAGESAVE TË EKSPERTËVE DHE DËSHMITARËVE GJATË PROCESIT GJYQËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 105/a të ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Masa e shpenzimeve të dëshmitarëve dhe pagesës së ekspertëve pjesëmarrës në seanca gjyqësore të përcaktohet sipas rregullave të këtij udhëzimi.
2. Çdo vit, gjykata e rrethit gjyqësor publikon listën e ekspertëve të licencuar dhe përditëson listën, në rastet kur autoritetet licencuese marrin masa administrative të pezullimit të licencës.
3. Gjykata thërret ekspertë të licencuar, të përcaktuar në listën që ajo disponon.
4. Në rast se në listë nuk figurojnë ekspertë në fushën e kërkuar ose kur asnjë nga ekspertët që figuron në listë nuk është i disponueshëm, Gjykata thërret ekspertë të tjerë, referuar veçantisë së fushës së kërkuar.
5. Dëshmitarët në një proces gjyqësor kanë të drejtën e mbulimit të shpenzimeve për dëshminë e dhënë.

II. KRITERET E PËRCAKTIMIT TË SHPENZIMEVE DHE PAGESAVE TË EKSPERTËVE

1. Caktimi i shpenzimeve që u takojnë ekspertëve bëhet në bazë të kushteve të mëposhtme:
 - a) Kur eksperti banon në një largësi deri në 100 km nga gjykata ku është thirrur për të kryer ekspertizën, trajtimi financiar i tij përfshin vetëm shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.
 - b) Kur eksperti banon në një largësi mbi 100 km nga gjykata ku është thirrur për të kryer ekspertizën, atij i përballohen shpenzimet e mëposhtme:
 - i) Dietë ditore, jo më shumë se 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë, kur ekspertiza zgjat më shumë se një ditë. Për efekt të llogaritjes së dietës, në këtë rast, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë;
 - ii) Shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me kuponin tatimor, por jo më shumë se 3 000 (tre mijë) lekë, për çdo natë;
 - iii) Shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.66, datë 27.2.2007 të Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar.
2. Pagesa për punën e kryer për ekspertimin nga eksperti i licencuar nuk mund të tejkalojë shumën 40 000 (dyzet mijë) lekë.

III. KRITERET E PËRCAKTIMIT TË SHPENZIMEVE TË DËSHMITARËVE

1. Caktimi i shpenzimeve, që u takon dëshmitarëve, bëhet, si më poshtë vijon:
 - a) Kur dëshmitari banon në një largësi deri në 100 km nga gjykata ku është thirrur për të dëshmuar, mbulimi i shpenzimeve të përfshijë vetëm shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifën përkatëse sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.307, datë 20.7.1992 të Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”.

b) Kur dëshmitari banon në një largësi mbi 100 km nga gjykata ku është thirrur për të dëshmuar, atij i përballohen shpenzimet e mëposhtme:

i) Dietë ditore, në masën jo më shumë se 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë;

ii) Shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me kuponin tatimor, por jo më shumë se 3000 (tre mijë) lekë, për çdo natë;

iii) Shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.307, datë 20.7.1992 të Këshillit të Ministrave “Për tarifat e transportit të udhëtarëve”.

c) Kur dëshmitari largohet nga vend i punës, shpërblehet në vlerë të barabartë me pagën ditore të ndërprerë. Shpërblimi kërkohet nga dëshmitari me anë të paraqitjes së një dokumenti me karakter vërtetues të vendit të punës dhe vlerës së pagës.

2. Nuk gëzojnë të drejtën e pagesës për dëshmitë e dhëna të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

IV. SHPENZIME TË VEÇANTA

Pagesat e përkthyesve të caktohen në bazë të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Financave, nr.3165, datë 12.5.2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e pagesës së përkthyesve të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, në bazë faqesh. Në rast se përkthyesit do të thirren për t’u paraqitur në gjykatë për të kryer shërbimet e tyre, përveç pagesës, u mbulohen edhe shpenzimet ditore në të njëjtën masë, referuar ekspertëve dhe dëshmitarëve.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Dokument tatimor, për efekt të këtij udhëzimi, do të konsiderohet çdo biletë transporti e miratuar nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe çdo faturë e thjeshtë apo me TVSH, e cila detyrimisht duhet të shoqërohet me kupon tatimor.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 169, datë 18.12.2012

PËR MIRATIMIN E SKEMËS SË PËRLLOGARITJES SË KAPACITETIT TOTAL TË TRANSMETIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe pikës 4, paragrafi i parë i “Rregullave të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi miratimin e skemës së përllogaritjes së kapacitetit total të transmetimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Procedura që ndiqet nga ana e shoqërisë OST sh.a. dhe nga çdo TSO e rajonit, bazuar në udhëzuesin operacional të ENTSO-e, për llogaritjen e kapaciteteve transmetuese ndërkufitarë është si më poshtë:



- 10 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen të dhënat, modeli nacional me të gjitha nyjet e nivelit 220/400 kV, ndërmjet TSO-ve, në formatin e aprovuar UCT, përfshirë rezervën e fuqisë aktive për rritjen/uljen e gjenerimit, dhe të dhëna mbi programin e remonteve (elementet jashtë pune) për periudhën e konsideruar;

- 5 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, kryhen llogaritjet (simulimet) për vlerat e TTC/NTC që rezultojnë nga plotësimi i kriterit N-1 të zbatuar për çdo zonë kontrolli;

- 2 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen vlerat e përcaktuara të TTC për çdo kufi, dhe fillon procesi i harmonizimit të tyre. Në rast mospërputhjeje të vlerave të llogaritura, dhe nëse palët nuk arrijnë të bindin njëra-tjetrën, atëherë vlera më e vogël e TTC hyn automatikisht në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë skemën e përlllogaritjes së kapacitetit total të transmetimit (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., mbi vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 8.1.2013
Doli nga shtypi më 9.1.2013

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 28 lekë